



KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 2 shkronja (d), neni 40 paragrafi 2 pika (c) të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008", neni 6 i Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimet e përkohshëm, neni 32.2 i Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, Kuvendi i Komunës në Dragash në mbledhjen e mbajtur me datën 27.04.2023 pas shqyrtimit dhe votimit paraprak, miraton këtë:

VENDIM PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS

Neni 1

Formohet komisioni për zgjedhës për intervistimin dhe vlerësimin e kandidatëve që kanë konkurruar në pozitën e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të Institucioneve Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese Parauniversitare që janë në varësi të Komunës për vitin 2022/2023 në këtë përbërje:

- 1.1 Faton Nafezi – Përfaqësues nga DKA - Kryesues,
- 1.2 Fatmir Mehmeti – Ekspert i pavarur i Arsimit,
- 1.3 Anëtar i tretë vjen nga MASH-ti, sipas udhëzimit administrativ, Nr.151/2020,
- 1.4 Anëtar - dy përfaqësues të kështillit drejtues të institucionit edukativo-arsimor, një prind dhe një mësues në cilësinë e vëzhguesve pa të drejtë vote në secilin institucion ku është duke u zhvilluar procedura e konkursit.

Neni 2

Detyrë e këtij komisioni për zgjedhës është që të bëjë intervistimin dhe vlerësimin e kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkursin për pozitë të drejtorit apo zëvendës drejtorit dhe në bazë të pikëve të fituar, bën ranglistën e kandidatëve dhe kandidatin më të suksesshem ja rekomandon Kryetarit të Komunës për emërim në pozitën e drejtorit apo zëvendës drejtorit të shkollës sipas konkursit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të prodhoj efekt juridik, pasi të plotësohen kushtet e parapara konform neneve 81 dhe 82 të LVL-së.

KUVENDI I KOMUNËS - DRAGASH

01 Nr. 060/01-8154-1/23

Dt. 27.04.2023

Kryesuesi i Kuvendit
Uran Halimi

